

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-680 S Betoncolor

VESHJE MBROJTËSE PËR BETONIN

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-680 S Betoncolor është veshje me 1 përbërës me përmbajtje tretësi, me bazë rrëshirash metakrilatesh dhe rezistencë ndaj konsumimit nga kushtet e motit, alkaleve dhe vjetërimit. Disponohet në ngjyrë të tejdukshme dhe ngjyra të tjera për përdorim mbi nënshtrësat minerale duke përfshirë betonin dhe sipërfaqe të tjera me bazë çimentoje. Sikagard®-680 S Betoncolor mbron betonin nga ndikimet atmosferike agresive dhe promovon një efekt vetëpastrues mbi sipërfaqet e trajtuara. Nuk ndikon negativisht teksturën karakteristike të betonit. Sikagard®-680 S Betoncolor plotëson kërkesat e EN 1504-2 si një shtresë mbrojtëse.

PËRDORIMET

Sikagard®-680 S Betoncolor përdoret për mbrojtje dhe përmirësim të betonit dhe materialeve të tjera prej çimentoje në ndërtesa dhe elemente infrastrukture. Sikagard®-680 S Betoncolor i tejdukshëm është një material pa ngjyrë, i cili kur thahet merr pamje të shkëlqyeshme dhe është i përshtatshëm si veshje rifreskuese dhe mbrojtëse për beton me agregate të ekspozuara.

Sikagard®-680 S Betoncolor shtresa përfundimtare, është veshje përfundimtare e cila kur thahet kthehet në mat, e disponueshme në numër të madh standardesh dekorative dhe në ngjyra speciale pothuajse të pakufizuara.

- I përshtatshëm për mbrojtje kundër depërtimit (Parimi 1, metoda 1.3, EN 1504-9),
- I përshtatshëm për kontroll të lagështisë (Parimi 2, metoda 2.3, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rritje të rezistencës (Parimi 8, metoda 8.3, EN 1504-9)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Sikagard®-680 S Betoncolor ofron rezistencë të shkëlqyer ndaj konsumimit nga moti dhe ka bazë rrëshirë metakrilike me tretës që avullojnë shpejtë
- Për shkak të vetive të tharjes të shpejtë, veshja është rezistente ndaj shiut brenda një kohe të shkurtër
- Pothuajse pa asnjë ndryshim në karakteristikat e teksturës së sipërfaqes të betonit
- Sikagard®-680 S Betoncolor mbron betonin nga ndikimet agresive atmosferike, të cilat mund të depërtojnë tek betoni në formën e kripërave ose gazeve
- Rezistencë shumë e lartë ndaj difuzionit të dioksidit të karbonit dhe si pasojë redukton ndjeshëm shkallën dhe thellësinë e karbonimit të betonit
- Përkushmëria e avujve të ujit nuk ndikohet negativisht
- Reduktohet grumbullimi i pislëqeve dhe betoni nuk çngjyroset më nga shiu
- I përshtatshëm për izolimin e betonit i cili nuk i ka fituar ende rezistencat e tij në veprat e inxhinierisë së ndërtimit

MIRATIME / STANDARDE

- Raport Nr.:A 2216/C1 data 22.11.1990, IBAC Aachen
- Raport Nr.:A 3026/B2 data 14.06.1996, IBAC Aachen
- Raport Nr.:P 3132-1 data 27.08.2003, Instituti i polimereve
- Ky sistem është regjistruar si një sistem produktesh sipas ZTV-ING pjesa 3, seksioni 4
- Veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, Deklaratë Performance 02 03 03 02 001 0 000001 2017, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0921, certifikatë pajtueshmërie nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 0921-BPR-2017, mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | | |
|--|---|---|
| Baza kimike | Rrëshirë akrilatësh në tretës | |
| Ambalazhi | Shtresë e tejdkushme e lëmuar | kovë 20 kg |
| | Veshja përfundimtare | kovë 12.5 dhe 30 kg |
| Paraqitja / Ngjyra | Shtresë e tejdkushme e lëmuar | Lëng i tejdkushëm |
| | Veshja përfundimtare | Pastë tiksotropike e disponueshme pothuajse në çdo ngjyrë |
| Jetëgjatësia | 36 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin original, të padëmtuar dhe të pahapur. | |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në kushte të thata dhe të freskëta. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe acari. | |
| Dendësia | Shtresë e tejdkushme e lëmuar | ~0.9 kg/l (në +20 °C) |
| | Veshja përfundimtare | ~1.4 kg/l (në +20 °C) |
| | Në varësi të ngjyrës, mund të ndodhin disa variacione të vogla. | |
| Pika e ndezjes | Shtresë e tejdkushme e lëmuar | +25 °C |
| | Veshja përfundimtare | +30 °C |
| Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim | Veshja përfundimtare: | ~45 % |

TË DHËNA TEKNIKE

| | | | |
|---|--|--|---------------|
| Rezistenca ndaj difuzionit të avujve të ujit | Trashësia e cipës së thatë | $d = 140 \mu\text{m}$ | (EN ISO 7783) |
| | Trashësia ekuivalente e shtresës së ajrit | $S_D, \text{H}_2\text{O} = 2.4 \text{ m}$ | |
| | Koeficienti i difuzionit të H_2O | $\mu\text{H}_2\text{O} = 1.8 \times 10^4$ | |
| | Kërkesat për transpirim | $S_D, \text{H}_2\text{O} \leq 5 \text{ m}$ | |
| Rezistenca ndaj karbonimit | Trashësia e cipës së thatë | $d = 130 \mu\text{m}$ | (EN 1062-6) |
| | Trashësia ekuivalente e shtresës së ajrit | $S_D, \text{CO}_2 = 429 \text{ m}$ | |
| | Koeficienti i difuzionit të CO_2 | $\mu\text{CO}_2 = 3.3 \times 10^6$ | |
| | Kërkesat për rezistencë ndaj karbonimit | $S_D, \text{CO}_2 \geq 50 \text{ m}$ | |

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

| | | |
|-----------------------------|---|--|
| Struktura e sistemit | Sikagard®-680 S Betoncolor shtresë e tejdkushme e lëmuar | |
| | Si mbrojtës dhe përmirësues i betonit me agregate të ekspozuara | 2 x Sikagard®-680 S Betoncolor shtresë e tejdkushme e lëmuar |
| | Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare | |
| | Në situatë normale | 2 x Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare |
| | Kur përdoren ngjyra të ndezura e verdhë dhe e kuqe | 3 x Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare |
| | Kur kombinohet me veshje prajmeri impregnimi hidrofob | 1 - 2 x Sikagard®-702 W ose Sikagard®-700 S 2 x Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | | |
|--|---|--------------------------|
| Konsumimi | Konsumimi me përafërsi për aplikim kg/m ² për veshje | |
| | Produkti | Për veshje |
| | Sikagard®-680 S Betoncolor shtresë e tejudkshme e lëmuar | ~ 0.15 kg/m ² |
| | Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare | ~ 0.20 kg/m ² |
| Trashësia e shtresës | Trashësia e thatë min. e kërkuar për arritjen e karakteristikave të qëndrueshmërisë së plotë (difuzioni i CO ₂ , ndërkapja pas cikleve termike, etj.) = 101 µm. Trashësia max. nuk duhet të arrijë përtej trashësisë ekuivalente të ajrit H ₂ O prej 5 m = 290 µm. | |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min. / +35 °C max. | |
| Lagështia relative e ajrit | < 85 % | |
| Pika e vesës | Temperatura e nënshtresës dhe ambientit duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës. | |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min. / +35 °C max. | |
| Koha e pritjes / mbiveshja | Koha e pritjes ndërmjet veshjeve: | |
| | Temperatura | Koha |
| | +10 °C | 8 orë |
| | +20 °C | 5 orë |
| | +30 °C | 3 orë |
| | Shënim: Veshjet rifreskuese të Sikagard®-680 S Betoncolor mund të aplikohen pa prajmer nëse veshja ekzistuese është pastruar plotësisht. | |
| Metoda e maturimit | Sikagard®-680 S Betoncolor nuk kërkon ndonjë trajtim të vecantë, por duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 1 orë në +20°C (nuk ngjit pluhur në 30 minuta në +20°C). | |
| Produkti i aplikuar gati për përdorim | Tharja e plotë: ~5 ditë në +20°C | |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton i ekspozuar pa veshje ekzistuese

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e qëndrueshme dhe pa grimca të lira dhe të shkrifëta.

Metodat e përshtatshme të përgatitjes janë pastrimi me avull, curril uji në presion të lartë ose pastrim me fryrje.

Betoni i ri duhet të ketë moshë të paktën 28 ditësh. Mund të përdoret (p.sh. Sika® MonoTop®-723 N, Sikagard®-720 EpoCem® etj.) - referohuni në skedën teknike përkatëse. Lejoni kohë tharjeje prej të paktën 4 ditësh përpara veshjes (me përjashtim të rastit kur përdoret EpoCem, atëherë veshja duhet të aplikohet brenda 24 orëve).

Beton i ekspozuar me veshje ekzistuese

Veshjet ekzistuese duhet të testohen për të konfirmuar ndërkapjen e tyre me nënshtresën - mesatarja e testit të ndërkapjes > 1.0 N/mm² pa asnjë vlerë të vetme nën 0.7 N/mm². Referohuni tek Method Statement përkatëse për më shumë detaje

Ndërkapje e pamjaftueshme

Veshjet ekzistuese duhet të hiqen plotësisht me

metoda të përshtatshme dhe nënshtresa duhet të ketë qëndrueshmëri të mjaftueshme dhe të jetë e përshtatshme për t' u veshur si më sipër.

Ndërkapje e mjaftueshme

Pastrim i plotë i të gjitha sipërfaqeve me pastrim me avull ose me curril uji në presion të lartë. Normalisht, Sikagard®-680 S Betoncolor mund të aplikohet mbi veshjen ekzistuese pa prajmer - rekomandohet kryerja e një testimi të ndërkapjes në shkallë të vogël përpara operimit në shkallë të plotë.

Shënim: Veshja ekzistuese me bazë uji, edhe nëse ka ndërkapje të mirë, duhet të hiqet plotësisht përpara aplikimit të Sikagard®-680 S Betoncolor.

APLIKIMI

Sikagard®-680 S Betoncolor është gati për përdorim. Përziëni mirë përpara aplikimit.

Mbi nënshtresat shumë absorbuese dhe/ose poroze, rekomandohet të shtohet rreth 50% Sikagard®-680 S Betoncolor i tejudkshëm tek veshja e parë e Sikagard®-680 S Betoncolor veshje përfundimtare për të forcuar nënshtresën dhe për të reduktuar rrezikun e një paraqitjeje jo të njëtrajtshme.

Sikagard®-680 S Betoncolor (shtresë e tejudkshme & veshje përfundimtare) mund të aplikohet me furçë ose rul me qime të shkurtëra.

Veshja përfundimtare mund të aplikohet gjithashtu

edhe me spërkatje pa ajër:
Presioni i spërkatjes 150 bar, diametri i hundëzës
0.38–0.66 mm, këndi i spërkatjes 50–80°.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

Mos aplikoni kur:

- Pritet shi
- Lagështia relative > 85%
- Temperatura është nën +5 °C dhe/ose nën pikën e vesës

Për fasada betoni me peshë të lehtë, rekomandojmë një veshje të ndërmjetme për ngushtimin e plasaritjeve si Sikagard®-550 W Elastic.

Në mjediset e marinës ose nëse sipërfaqja e betonit është e ekspozuar ndaj spërkatjes nga kripërat për shkrirjen e akullit, rekomandohet impregnimi Sikagard®-702 W Aquaphob ose Sikagard-700 S si prajmer i padepërtueshëm nga uji.

Në beton me sipërfaqe të dukshme dhe të parafabrikuar pa mbushës të mjaftueshëm poresh (p.sh. Sika® MonoTop®- 723 N ose Sikagard® -720 EpoCem®), mund të shfaqen fluska nëse aplikimi kryhet gjatë temperaturave në rritje.

Sistemi është plotësisht rezistent ndaj të gjitha ekspozimeve atmosferike normale dhe shirave. Spërkatja nga uji i cili përmban kripë për shkrirje akulli ose ujë deti, mund të shkaktojë humbje të shkëlqimit dhe ndryshim në ngjyrë. Megjithatë, performanca mbrojtëse nuk ndikohet negativisht.

Ngjyrat e errëta (veçanërisht e zeza, e kuqja e errët dhe bluja, etj) mund të zbehen më herët se tonet më të hapura të ngjyrave. Mund të nevojitet veshje rifreskuese me herët sesa zakonisht.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-680 S Betoncolor

Mars 2019, Botimi 03.01

020303020010000001

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori Produkti IIA / i lloji sb) është 600 (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard®-680 S Betoncolor është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikagard-680SBetoncolor-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf